



MBLEDHJE E BORDIT TË ENTIT RREGULLATOR TË ENERGJISË

Tiranë më 21.07.2016

**Bordi i Entit Rregullator të Energjisë, në mbledhjen e tij të datës
21.07.2016 pasi shqyrtoi relacionet e përgatitura nga drejtoritë teknike të
ERE-s mori vendimet si më poshtë :**

- Vendim nr. 118, datë 21.07.2016 mbi ankimin administrativ të OSHEE sh.a ndaj vendimit nr. 103, datë 23.06.2016, “Mbi miratimin e rregullores për procedurat e blerjes së energjisë elektrike për mbulimin e humbjeve në rrjetet e shpërndarjes dhe të transmetimit dhe për blerjen dhe shitjen e energjisë elektrike për të siguruar përmbushjen e detyrimeve të shërbimit publik”
- Vendim nr. 119, datë 21.07.2016 për miratimin e “Rregullores së procedurave të transferimit të asetëve nga të licencuarit”
- Vendimi nr.120, datë 21.07.2016 mbi licencimin e shoqërisë “reka energy” sh.p.k, në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga hec –et “zaje” me fuqi të instaluar 220 kw, “turaj” me fuqi të instaluar 320 kw, “xhaferaj-meshteken” me fuqi të instaluar 3680 kw, “novosej” me fuqi të instaluar 220 kw, dhe “kollovoz” me fuqi të instaluar 1500 kw, me fuqi totale të instaluar 5940 kw.
- Vendimi nr.121, datë 21.07.2016 mbi licensimin e shoqërisë “Nordic invest group” sh.p.k. në aktivitetin e tregëtimit të energjisë elektrike “
- Vendimi nr. 122, datë 21.07.2016 mbi fillimin e procedurave për licensimin e shoqërisë “prell energy” sh.p.k në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga hec “prellë” me fuqi të instaluar 14970 kw

- Vendimi nr. 123, datë 21.07.2016 mbi miratimin e licensës për veprimtarinë e operimit të tregut të energjisë elektrike